



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 958 / Prot.

Vlorë më, 19.03 .2025

**VENDIM
Nr. 35, datë 19.03.2025**

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "SPECIALIST NË
SHËRMBIME DHE OPERACIONE DETARE E BREGDETARE"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen , rioorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë*" si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave me nr. 951 datë 19.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024,


VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit "Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj





UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" I VLORËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I SHEKNCAVE DETARE

Adresa /Address: Sheshi Pavarësia, Skelë – Vlorë
Web-site: www.univlora.edu.al

RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
“SPECIALIST NË SHËRBIME DHE OPERACIONE
DETARE E BREGDETARE”

Kjo rregullore është e hartuar në frymën e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës dhe konforme rregullores së DSHD.

Nevojat reale

Rregullorja merr parasysh nevojat reale të pedagogëve, studentëve. Në këtë kontekst, “Rregullorja” fokusohet në normimin dhe disiplinimin e veprimtarisë mësimore në përputhje me objektivat e programit mësimor profesional “Specialist në shërbime dhe operacione detare e bregdetare”.

Studenti

Ne besojmë që secili student që bëhet pjesë e DSHD duhet të arrijë plotësim të kënaqshëm të vetvetes në termna edukimi, në mënyrë që të japë kontribut të vlefshëm në profesionin e tij.

Gjithashtu:

Të nxënëet është një proces që evolon vazhdimisht dhe është më rezultativ, kur zhvillohet në një mjedis pozitiv të nxëni.

Bashkëpunimi brenda institucional dhe ndërinstitutional efektiv ndikon në konsolidimin e programeve të edukimit.

GRUPI I PUNËS

Prof. Dr. Kristofor Lapa

Prof. As. Ermal Xhelilaj

MSc.Suard Alizoti

PËRMBAJTIA

Neni 1: Emërtimi dhe statusi i programit.....	4
Neni 2: Objektivat formuese të programit të studimit.....	4
Neni 3: Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese.....	5
Neni 4: Ngarkesa mësimore në orë sipas formave të mësimdhënies.....	6
Neni 5: Plani mësimor i programit për të dy vitet e studimit.....	6
Neni 6: Të drejtat dhe detyrat e studentit.....	7
Neni 7: Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.....	7
Neni 8: Kurrikulat e ofruara për studentët.....	7
Neni 9: Forma dhe organizimi i studimit të programit profesional “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare”	8
Neni 10: Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët.....	8
Neni 11: Kushtet për t’u konsideruar kalues në një lëndë.....	8
Neni 12: Proçedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve.....	9
Neni 13: Rikontrollimi i dijeve të fituara.....	9
Neni 14: Orari i studimit dhe provimeve.....	10
Neni 15: Detyrimet e mundshme, që lidhen me frekuentimin.....	10
Neni 16: Karakteristikat e Detyrave/ Projekteve të kursit.....	10
Neni 17: Provimi Përfundimtar.....	10
Neni 18: Modalitetet për dhënien e diplomës.....	10
Neni 19: Proçedura e diplomimit.....	11
Neni 20: Shkeljet e rregullave të fakultetit.....	11
Neni 21: Shkeljet e integritetit akademik.....	12
Neni 22: Kushtet për proçedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve.....	13
Neni 23: Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve.....	13
Neni 24: Dispozita të veçanta.....	13

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

Departamenti i Shkencave Detare është një nga Departamentet më të vjetër të Universitetit "Ismail Qemali", i hapur në vitin akademik 1998-1999, mbështetur në Ligjin Nr.7967 datë 20.07.1995, me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr.145 datë 04.08.1998 dhe Nr.2909/2 Prot. Për: "Hapjen e kursit të studimit universitar të Navigacionit" në Universitetin Teknologjik "Ismail Qemali" të Vlorës. Nëpërmjet këtij programi studimi që i përket nivelit 5 të kornizës shqiptare të kualifikimeve, Departamenti i Shkencave Detare, synon të ofrojë një formim adekuat akademik për të përgatitur profesionistët e ardhshëm, të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin rajonal dhe kombëtar të vendit në fushën e shërbimeve dhe operacioneve detare e bregdetare. Programi studimor profesional dyvjeçar "Specialist në shërbime dhe operacione detare e bregdetare" është program i ofruar nga Departamenti i Shkencave Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, dhe është i organizuar në dy vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit studentët grumbullojnë 120 ECTS dhe marrin Diplomën Profesionale **"Specialist në shërbime dhe operacione detare e bregdetare"**.

Neni 2

Objektivat formuese të programit të studimit

Përmes bashkëpunimit me njësi të tjera të Universitetit tonë, organizata të ndryshme, Universitete të tjera, brenda dhe jashtë vendit, Departamenti i Shkencave Detare synon të përgatisë kuadro të specializuar, të cilët të disponojnë aftësi për t'ju përgjigjur jo vetëm nevojave të sistemit të transportit detar dhe intermodal por edhe operacioneve të tjera ndërsektoriale sidomos në turizmin detar e bregdetar, për të cilat nevojitet ekspertizë teknike, operative, llogjistike, ligjore, ekonomike. Rrjedhimisht, ky program studimi përbën një risi për Universitetin e Vlorës pasi u adresohet sipërmarrjeve publike e private të lidhura me: transportin detar, aktivitetet portuale, transportin rrugor, hekurudhor e ajror si edhe me llogjistikën e transportit dhe me tregtinë ndërkombëtare.

Objektivat kryesorë të programit të studimit janë të formojë një profil specialisti të aftë të:

- Të njohë llojet e shërbimeve që aktorët të cilët veprojnë në det ofrojnë apo për të cilat kanë nevojë;
- Të njohë operacionet që zhvillohen në port dhe në anije, në portet turistike dhe në mjetet e lundruese të të gjitha tipeve dhe përmasave.
- Të planifikojë, të organizojë, të menaxhojë shërbimet dhe operacionet që zhvillohen në funksion të bizneseve, sipërmarrjeve, institucioneve të lidhura me detin dhe aktorëve që operojnë në det si: portet tregtare, agjensitë e transportit detar e intermodal, agjensitë speditore, ndërmjetësuesit detar (broker), dispeçeritë, bizneset e peshikimit, operatorët dhe portet turistike, anijet e transportit turistik, anijet rekreative, anijet tregtare;

Neni 3

Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese.

Prioritet i Departamentit të Shkencave Detare, gjatë zhvillimit të programit profesional “Specialist në shërbime dhe operacione detare e bregdeare”, do të jetë jo vetëm pajisia e studentëve me njohuritë e nevojshme shkencore e profesionale por edhe zhvillimi i aftësive që mundësojnë përshtatjen me kontekstet e reja ekonomike të cilat janë sa komplekse aq edhe dinamike në dimensionin detar. Disiplinat mësimore të parashikuara për të formuar profilin e specialistit të shërbimeve dhe operacioneve detare e bregdetare paraqiten në Tabelën 1, në vijim:

Tabela 1				Kredite
NDARJA E LËNDËVE SIPAS TIPIT TË VEPRIMTARIVE FORMUESE				
Lëndë Bazë-përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithëshme. (15-20 %) (18 ECTS – 24 ECTS) 18 ECTS Kredite	1	MAT-E 154	Analizë Matematike 1	6
	2	FIZ-E 151	Fizike I	6
	3	DET237	Rrjetet e bashkëpunimit në Ekonominë blu	6
Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disipinën shkencore.(50-55%) 60 ECTS – 66 ECTS	4	DET133	Lundrim dhe Siguri Detare	7
	5	DET134	E drejta e detit dhe legjislacioni tregtar i transportit detar	6
	6	DET135	Menaxhimi i aktiviteteve në bord të anijes	6
	7	DET136	Leadershipi, organizatat detare dhe faktori njerezor	5
	8	DET137	Shërbimet dhe aktivitetet në portet turistike	6
	9	DET231	Operacione Portuale dhe praktika administrative	6
	10	DET232	Sipërmarrjet mbështetëse dhe Shërbimet në industrinë detare	6
	11	DET233	Përpunim ngarkese dhe aspektet e sigurisë teknike	6
	12	DET234	Aspektet tregtare e operacionale te sistemeve të komunikimit detar	6
	13	DET235	Menaxhimi i mjedisit dhe i resurseve bregdetare	6
Lëndë Ndërdisiplinore/ Integruese-nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (12-15%). 14 ECTS – 18 ECTS	14	DET236	Emergjencat detare e bregdetare dhe menaxhimi i riskut	6
	15	DET131	Ekologji Detare	6
		DET132	Histori e Artit Detar	
	16	DET238	Transporti intermodal dhe llogjistikë e integruar transporti	6
Lëndë plotësuese-Gjuhë të Huaja, praktike dhe Informatike (10-15 %) 12 ECTS – 18 ECTS	17	CST 130	Teknologji Informacioni dhe komunikimi	6
	18	DET239	Praktikë Profesionale	6
	19	ENG-T 131	Anglishte Detare	6
Detyrime Përmbyllëse (3-5%).Temë Diplome/Provimi Formimi 6 -9 Kredite	20	DET240	Provimi Formimi	6

Neni 4.

Ngarkesa mësimore në orë sipas formave të mësimdhënies

Shpërndarja e orëve mësimore gjatë hartimit të programit profesional “**Specialist në shërbime dhe operacione detare e bregdeare**”, është bërë duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Neni 5

Plani mësimor i programit “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare” për të dy vitet e studimit

Tabela 3- Plani mësimor i Diplomës Profesionale, “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare”												
Viti	Semestri	Nr	Kodi	Lënda	Kredite	Tot. orë / semester Brenda & jashtë auditorit	Tot.orë / semester në auditor	Totali orë / javë në auditor				Totali orë jashtë auditorit
								Leks	Sem	Lab/Pr-Javë	Projekt kursi/ Detvrë kursi	
Viti i parë	Sem I	1.	MAT-E 154	Analizë Matematike 1	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		2.	FIZ-E 151	Fizike 1	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		3.	CST 130	Teknologji Informacioni dhe komunikimi	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		4.	ENG-T131	Anglishte Detare	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		5.	DET131	Ekologji Detare	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
	DET132	Histori e Artit Detar										
	TOTAL				30	750	375	15	10	0/0	0/0	375
	Sem II	6.	DET133	Lundrim dhe Siguri Detare	7	175	75	3	1	1/0	0/1	100
		7.	DET134	E drejta e detit dhe legjislacioni tregtar i transportit detar	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		8.	DET135	Menaxhimi i aktiviteteve në bord të anijes	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		9.	DET136	Leadershipi, organizatat detare dhe faktori njerezor	5	125	75	3	2	0/0	0/0	50
		10.	DET137	Shërbimet dhe aktivitetet në portet turistike	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
TOTAL				30	750	375	15	9	1/0	0/1	375	
				60	1500	750	30	19	1/0	0/1	750	
Viti i dytë	Sem I	11.	DET231	Operacione Portuale dhe praktika administrative	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		12.	DET232	Sipërmarrjet mbështetëse dhe Shërbimet në industrinë detare	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		13.	DET233	Përpunim ngarkese dhe aspektet e sigurisë teknike	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		14.	DET234	Aspektet tregtare e operacionale te sistemeve të komunikimit detar	6	150	75	3	2	0/0	0/1	75
		15.	DET235	Menaxhimi i mjedisit dhe i resurseve bregdetare	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
	TOTAL				30	750	375	15	10	0/0	0/1	375
	Sem II	16.	DET236	Emergjencat detare e bregdetare dhe menaxhimi i riskut	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		17.	DET237	Rrjetet e bashkëpunimit në Ekonominë blu	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		18.	DET238	Transporti intermodal dhe llogjistikë e integruar transporti	6	150	75	3	2	0/0	0/0	75
		19.	DET239	Praktikë Profesionale	6	150	75	0	5	0/0	0/0	75
		20.	DET240	Provim Formimi	6	150	0	0	0	0/0	0/0	150
	TOTAL				30	750	300	9	11	0/0	0/0	450
				60	1500	675	24	21	0/0	0/1	825	
TOTAL I TË DY VITEVE				120	3000	1425	54	40	1/0	0/2	1575	

Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e studentit

Studenti ka të drejtë:

- të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e leksioneve dhe të veprimtarive të tjera të parashikuara në programin e studimeve;
- të pajiset kundrejt pagesës, me materialet mësimore (tekste dhe leksione të shkruara);
- të shfrytëzojë bibliotekën e fakultetit apo të njësisë përkatëse të kërkimit;
- të tërhiqet vullnetarisht nga programi duke paraqitur kërkesën me shkrim;

Studenti ka për detyrë:

- të njohë rregulloren e programit të studimit si edhe bazën ligjore përkatëse (VKM, Udhëzime të MASH etj.)
- të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligjet, vendimet, udhëzimet e rregulloret;
- të ndjekë programin e studimit.
- të arrijë rezultate të larta në realizimin e programit të studimit.
- t'i shlyejë në kohën e duhur Universitetit (fakultetit), të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga regjistrimi dhe vazhdimi i studimeve në këtë program.
- Të përfundojë studimet brenda limiteve kohore të parashikuara ligjërisht.

Neni 7

Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese

Studenti që ndjek programin mësimor “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare” mund të regjistrohet në lëndët e vitit të dytë vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 30 ECTS në këtë program studimi.

Neni 8

Kurrikulat e ofruara për studentët

Kurrikulat e ofruara për studentët nga Departamenti i Shkencave Detare janë paraqitur në syllabyset përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës. Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Shkencave Detare për programin profesional “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare” mund të tërhiqet pranë sekretarisë së FSHTN, pas pagesës përkatëse.

Neni 9

Forma dhe organizimi i studimit të programit profesional “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare”

Në programin mësimor “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare” veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, ushtrime, seminare, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje për provimin final etj). Leksionet, seminarët dhe laboratorët zhvillohen në ambientet e Universitetit ‘Ismail Qemali’ Vlorë. Grupet mësimore të këtij programi organizohen si më poshtë (VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”):

Numri i studentëve në leksion	30 studentë
Numri i studentëve në seminar	30 studentë
Numri i studentëve në praktika	30 studentë

Neni 10

Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët.

Programi mësimor “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare” parashikon në total 20 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore, praktikës mësimore dhe temës së diplomës. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, temat e diplomës.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/ detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final). (kreu II, pika 5, udhëzimi nr. 15 i MASH)

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim e me gojë duke u mbështetur në programin mësimor.

Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Në përfundim të programit të studimit studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese. (kreu VII, pika 7, udhëzimi nr. 15 i MASR)

Neni 11

Kushtet për t’u konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/ projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht,

konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/ projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 41\%$ në të gjitha lëndët. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Detare.

Për modulet e integruara (nëse ka dhe që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 41\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 12

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të FSHTN bëhet me një provim paraprak dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit apo skedave të vlerësimit në laboratore dhe praktika mësimore.
2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. Në qoftë se është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. Në qoftë se studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi AD-HOC për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 13

Rikontrollimi i dijeve të fituara

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet t'u nënshtrohen kontrolleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara, kontrolle këto për të garantuar mosvjetërimin e dijeve dhe përditësimin e tyre për kreditet e fituara më parë.

Edhe studentët që u kanë zgjatur studimet më shumë se dy vjet përtej kohës normale të fitimit të Diplomës "Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare", u kontrollohen kreditet e fituara.

Neni 14

Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga FSHTN. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësuesit e Fakultetit. Orari i përgjithshëm duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë pas përfundimit të semestrit. Orari duhet të jetë i detajuar me sallat përkatëse dhe mund të ndryshojë vetëm me miratimin e zëvendës-rektorit akademik ose rektorit të UV.

Neni 15

Detyrimet e mundshme, që lidhen me frekuentimin.

Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.
Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.

Neni 16

Karakteristikat e Detyrave/ Projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit në programin e studimit profesional “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare” do të jenë dy tipesh: (individuale ose në grup).

Neni 17

Provimi Përfundimtar

Në fund të programit të studimit, në kurrikul është parashikuar provim formimi i cili konsiston në kontrollin e dijeve të studentit në disiplinat kryesore për të cilat ka marrë njohuri gjatë periudhës 2-vjeçare të studimeve në programin e studimit profesional “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare”.

Neni 18

Modalitetet për dhënien e diplomës në programin e studimit profesional “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare”

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së programit të studimeve profesionale “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare”, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore – UV janë si vijon:

1. Studenti duhet të ketë shlyer gjithë detyrimet akademike dhe të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha disiplinat, respektivisht sipas kategorive: disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese, disiplina ndërdisiplinore/integruese, disiplina plotësuese.
2. Studenti duhet të ketë vlerësim “kalues” në Provimin Përfundimtar, sipas kërkesave të paraqitura në Nenin 17 të Rregullores së këtij programi mësimor.

3. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar 120 ECTS (kredite).

Neni 19

Procedura e diplomimit

1. Studenti paraqet në Sekretarinë e Departamentit të Shkencave Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore kërkesën për diplomim, së bashku me gjeneralitetet personale.

2. Në bazë të kërkesës së studentit merret një kopje e listës së notave të studentit nga Zyra e Rregjistrimit të "Universitetit Ismail Qemali"-Vlorë.

3. Komisioni i verifikimit të diplomave verifikon plotësimin e kriterëve të diplomimit për **programin profesional "Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare"**

4. Nëse pas verifikimit konstatohet se studenti i ka plotësuar kriteret për t'u diplomuar, Departamenti i Shkencave Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore paraqet në Rektorat propozimin e diplomimit të studentit në fjalë.

5. Pasi Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" aprovon kërkesën përpihet diploma dhe suplementi i saj për çdo student.

6. Studenti tërheq formularin për marrjen e diplomës pranë sekretarisë së FSHTN dhe paraqitet në Bankë për të bërë pagesën.

7. Pasi bën pagesën, me faturën e bankës tërheq Diplomën pranë sekretarisë së FSHTN.

8. Nëse studentit i nevojitet program mësimor, merr formularin për program pranë sekretarisë së FSHTN, bën pagesën në Bankë, më pas tërheq programin e firmosur nga Dekani i FSHTN dhe të vulosur nga sekretaria.

Neni 20

Shkeljet e rregullave të fakultetit

Shkelje të rregullave të FSHTN konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që mund të cënojnë personalitetin e mësimdhënësit apo të çdo punonjësi tjetër të Universitetit; gjithashtu shkelje konsiderohen cënimi i normave etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.

Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim;
- përjashtim nga shkolla për një vit;
- përjashtim nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës;
- përjashtim përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës.

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Dekanati i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.

Vendimin për përjashtimin nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasëshme) e merr Rektori i Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

Neni 21

Shkeljet e integritetit akademik

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.
2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këta studentë të pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrashimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrashimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.
3. Mashtrim në raporte laborator duke fallsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.
4. Fallsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterike, duke përfshirë modifikimin e skedarëve kompjuterike, të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laborator dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë, përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy

anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 22

Kushtet për procedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko– ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza dhe rekomandimi. Dokumentat duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat e Pushtetit Lokal, këto dokumenta duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra me radhë, duhet të aplikojnë përsëri për pranim në Universitet. Vendimi merret nga një komision i ngritur nga Rektorati.

Neni 23

Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve

Procedurat transferuese në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore përcaktohen në rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës. Procedurat transferuese përfundojnë përpara fillimit të semestrit.

Neni 24

Dispozita të veçanta

Departamenti i Shkencave Detare dhe Dekanati i FSHTN-së rezervojnë të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.

DREJTUESI I NJËSISË BAZË TË

DEPARTAMENTIT TË SHKENCAVE DETARE

Profesor Doktor Kristofor LAPA

